



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
KOMISIONI I DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT

Nr. 115 Prot.

Tiranë, më 27.08.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me Urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhërin nr. 56, datë 23.03.2023 "Për një ndryshim në Urdhërin nr. 21, datë 06.02.2023 "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 27, datë 27.08.2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisurve, fashikull nr. 199/9, në ngarkim të B. F., me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1971-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
2. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisurve, fashikull nr. 199/7, në ngarkim të B. F., me 245 (dyqind e dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1967-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
3. Arkiva e Autoritetit, Fondi të Arratisurve, dosje formulare nr. 117, në ngarkim të B. Ç., me 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1944-1958. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
4. Arkiva e Autoriteti, Fondi Instituti, dosja nr.22, bashkëpunimi dhe kordinimi i punës agjentorale operativ ndërmjet organeve të sigurimit të shtetit të policisë e kufirit, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973- 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".
5. Arkiva e Autoriteti, Fondi Instituti, dosja nr.8, studimi bashkëpunimi e bashkërendimi i masave midis organeve të Sigurimit të policisë e të kufirit për zbulimin e parandalimin në kohë të veprimatrisë armiqësore të tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Sekret".

6. Arkiva e Autoriteti, Fondi Instituti, dosja nr.19, përshkrim për shkaqet e arratisjes të dy personave në Jugosllavi, me 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
7. Arkiva e Autoriteti, Fondi Instituti, dosja nr.16, mbi veçoritë e punës së organeve të Sigurimit të Shtetit, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.
8. Arkiva e Autoriteti, Fondi Drejtoria e II, dosja pa numër, fashikuj me proces-verbale të thyesve të kufirit, me 254 (dyqind e pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1957. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4 të ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në Vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.01.2023, pika 1 e dispozitivit.
2. Ngarkohet Sekretari i KDZH, të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.
 3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar, t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.
 4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula

